



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 18.12.2018, ora 09.30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10997, datë 13.12.2018 “Për kthimin e ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””.
3. Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 711, datë 23.11.2018, të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
4. Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga 28 deputetë të Kuvendit të Republikës të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
5. Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Reme Lala, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Mimoza Dhembli – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Ridvan Bode – kandidat për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Suela Popa - kandidate për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Edlira Luçi - kandidate për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Artan Hoxha - kandidat për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Arben Malaj - kandidat për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
Luljeta Minxhozi - kandidate për Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëdita!

Duke ju kërkuar ndjesë për vonesën, fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat. Sot do të kemi një ditë të gjatë pune në dy sallat këtu dhe në sallën tjetër, atë të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Fillojmë mbledhjen me shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10997, datë 13.12.2018 “Për kthimin e ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019””. Më pas do të vijojmë me një seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave, vendimi nr. 711, datë 23.11.2018, të tre anëtarëve për Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Do të vijojmë me seancën dëgjimore me tri kandidaturat e propozuara nga 28 deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për tre vendet vakante për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Më tutje do të vijojmë mbledhjen që kemi nisur që me seancën dëgjimore për shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me çështjen e parë për shqyrtimin e dekretit të Presidentit për kthimin pas të ligjit “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” ndodhet në Komisionin e Ekonomisë, ministri i Financave dhe Ekonomisë, zoti Arben Ahmetaj. Do të doja t’ju bëja me dije që komisioni ka njoftuar për këtë mbledhje dhe ka kërkuar prezencën edhe të një përfaqësuesi nga institucioni i Presidentit të Republikës që ka autoritetin për të folur në emër të Presidentit të Republikës, natyrisht edhe për të mbrojtur argumentet e dekretit të prezantuar prej tij. Deri tani nuk është paraqitur askush, kështu që do të fillojmë menjëherë me relatimin e relatores së komisionit, zonjës Evis Kushi, lidhur me dekretin e Presidentit dhe më pas me opinionin e ministrit të Ekonomisë dhe Financave në emër të qeverisë.

Zonja Kushi, fjala për ju.

Evis Kushi – Faleminderit, kryetar!

Presidenti i Republikës me dekretin e datës 13 dhjetor ka kthyer për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” dhe këtë e ka bazuar në nenin 85, pika 1 e Kushtetutës. Sipas dekretit arsyet e kthimit të këtij ligji në Kuvend lidhen me situatën më të fundit politike, protestën e studentëve dhe me kërkesat e tyre për një mbështetje

më të madhe buxhetore për arsimin, sidomos për arsimin e lartë. Sipas dekretit, meqenëse këto kërkesa të studentëve kanë gjetur një mbështetje të gjerë publike si kërkesa të drejta dhe të arsyeshme, atëherë Presidenti i Republikës me anë të këtij dekreti kërkon që qeveria dhe Kuvendi i Shqipërisë të shfrytëzojnë çdo hapësirë dhe çdo mundësi financiare për të plotësuar kërkesat e studentëve për një arsim më cilësor dhe për shanse të barabarta për gjithë të rinjtë, pavarësisht të ardhurave apo mundësive të tyre ekonomike.

Duke e vlerësuar këtë përpjekje apo këtë iniciativë të Presidentit të Republikës për të dhënë kontributin e tij për këtë situatë, dua t’ju parashtroj disa mendime dhe argumente, të cilat më pas do të na çojnë në një konkluzion për t’u sugjeruar kolegëve të komisionit miratimin apo mosmiratimin e këtij dekreti.

Së pari, ligji “Për buxhetin e shtetit të vitit 2019” është në përputhje të plotë me Kushtetutën. Në nenin 57, pika 1 e Kushtetutës, përcaktohet e drejta e çdo personi për arsimim. Gjithashtu, në nenin 59 të Kushtetutës përcaktohen objektivat sociale që synon shteti, ku përfshihet midis tyre edhe e drejta për arsimim apo për kualifikim të fëmijëve, të të rinjve dhe të gjithë personave që janë jo të zënë me punë. Por, po në të njëjtin nen përcaktohen edhe objektiva të tjerë socialë përveç arsimimit, siç janë punësimi, strehimi, standardi më i lartë shëndetësor, përkujdesja dhe ndihma për shtresat në nevojë, mbrojtja e mjedisit, mbrojtja e trashëgimisë kulturore e kështu me radhë. Në këtë nen përcaktohet se këto objektiva socialë shteti synon t’i realizojë brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Dua të theksoj që në pikën 2 të nenit 57 theksohet, po e citoj fjalë për fjalë siç është në Kushtetutë: “Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektivave”.

Pra, kushtet dhe masa e realizimit të objektivave sociale të shtetit përcaktohen me ligj të veçantë. Kjo do të thotë që objektivat sociale shteti i plotëson dhe duhet t’i realizojë brenda mundësive të tij financiare. Në përputhje me këto përgjegjësi, nuk dua t’i përmend shumë shifrat, sepse të gjithë i kemi tabelat e buxhetit sa i takon pjesës së arsimit, por dua t’ju theksoj vetëm një fakt që buxheti për arsimin parashikon 42 miliardë lekë fonde, që përbëjnë rreth 8,1% të shpenzimeve të përgjithshme dhe 1,2 miliardë lekë më shumë se viti 2018. Ndërsa, po të përqendrohemi tek arsimi i lartë, shpenzimet për arsimin universitar për vitin 2019 në buxhet janë parashikuar në nivelin 7,5 miliardë lekë, përsëri janë më të larta se viti i kaluar me rreth 190 milionë lekë.

Pra, po dal në konkluzionin e argumentit të parë. Shteti brenda mundësive të tij financiare, qeveria me anë të buxhetit të shtetit, ka siguruar mbështetje financiare për sektorin e arsimit, pavarësisht se ende jo në përputhje të plotë me nevojat, por ama buxheti është shumë më i lartë se sa vitet e kaluara. Për këtë arsye edhe në vitet e kaluara pavarësisht se mbështetja e buxhetit për arsimin nuk ka qenë në përputhje të plotë me nevojat, përsëri Presidenti i Republikës e ka dekretuar ligjin e buxhetit për arsyet që ju thashë më lart.

Së dyti, një ndër synimet kryesore të buxhetit edhe për vitet e mëparshme jo vetëm i këtij viti është mbështetja dhe zhvillimi i sektorëve prioritarë, si dhe zhvillimi i balancuar i sektorëve të tjerë të ekonomisë, sepse kjo lloj politike ndihmon në zhvillimin e punësimit, zhvillimin ekonomik, rritjen e prodhimit dhe në përgjithësi në rritjen e mirëqenies së qytetarëve. Prandaj buxheti i vitit 2019 ka vendosur disa prioritetet midis të cilave është edhe arsimi, por përveç arsimit janë bujqësia, shëndetësia dhe mbrojtja sociale, si dhe infrastruktura.

Së treti, ne mendojmë se kërkesat e studentëve mund të plotësohen edhe pa e prekur buxhetin e shtetit, pa bërë ndryshime. Pra, ne mendojmë që kërkesat në pjesën më të madhe mund të plotësohen, duke i përdorur fondet që janë në dispozicion me efektivitet, me eficiencë dhe me ekonomi.

Së katërti, nuk duhet të harrojmë që aktualisht qeveria ka marrë disa iniciativa shumë të rëndësishme sa i takon përmirësimit të kushteve të jetesës në konvikte të studentëve. Këtu dua të ndalem në tri marrëveshje shumë të rëndësishme që janë bërë së fundi midis qeverisë shqiptare, qeverisë gjermane dhe qeverisë franceze. Bëhet fjalë për një fond prej 18,8 milionë euro, i cili është një investim që nuk është bërë asnjëherë më parë në kampuset universitare të Shqipërisë. Po ashtu, dua të theksoj që një nga kërkesat e studentëve tashmë ka marrë zgjidhje, e kam fjalën për tarifat e provimeve të mbartura, ku me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave të para disa ditëve kjo çështje ka marrë zgjidhje.

Pra, duke u mbështetur në gjithë këto argumente, mendoj se buxheti i shtetit i vitit 2019 është në përputhje me Kushtetutën, prandaj u sugjeroj kolegëve të komisionit të mos e miratojnë dekretin e Presidentit për kthimin e këtij buxheti.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zonja Kushi!

Fjalën e ka ministri i Financave, për opinionin e qeverisë lidhur me dekretin e Presidentit të Republikës.

Arben Ahmetaj – Besoj se zonja Kushi na bëri si argumentin kushtetues, edhe atë procedural në të njëjtën kohë. Dua t'ju theksoj se nga ana procedurale buxheti i vitit 2019, qoftë në instrumente, qoftë në shuma i ka të gjithë mundësitë dhe hapësirat për të plotësuar kërkesat përtej 8 pikave të studentëve. Këtu gjej rastin të bëj një lutje për studentët që kanë qenë në protestë, që të hyjnë menjëherë në dialog me qeverinë, me Kryeministrin, për arsyen se sa më shpejt të ulemi aq më shpejt do t'i zgjidhim dhe do t'i plotësojmë të gjitha kërkesat legjitime të studentëve.

Besoj që Presidenti është munduar të ketë një kontribut, duke e kthyer buxhetin e vitit 2019. Po ju citoj një nen të Kushtetutës që në themel të tij ka dy shtylla, shtyllën e së drejtës të plotësimit të të gjitha nevojave sociale dhe shtyllën e mundësive. Besoj se një kontribut më të madh se sa të kthesh buxhetin e shtetit që është i furnizuar me të gjitha instrumentet dhe shumat për arsimin e lartë dhe jo vetëm për të, do të ishte njëlloj që, si Kryeministri, si edhe ne këtu, edhe ai të kërkonte dialog midis studentëve dhe qeverisë. Sot qeveria ka një pozicion shumë të qartë, mbështet tërësisht kërkesat e studentëve, i konsideron legjitime dhe shumë të natyrshme në reflektim të kushteve të jetesës që duhen përmirësuar, të kostos së arsimimit nëpërmjet uljes së tarifave, pra të subvencionimit nga ana e buxhetit të shtetit, por sigurisht qeveria është duke pritur me padurim që studentët të ulen dhe të dialogojnë me Kryeministrin dhe me qeverinë në mënyrë që të mos kemi vetëm ato 8 pikat, por të kemi një pakt kombëtar të qeverisë me studentët, në mënyrë që të mos kemi një zgjidhje *ad hoc* vetëm për momentin, por të kemi një plan afatgjatë së bashku me studentët për zgjidhjen e problemeve të shtruara nga ana e tyre me dinjitet dhe në legjitimitet të plotë.

Në këndvështrimin tim personal, por edhe si përfaqësues i qeverisë këtu, besoj që sot studentët kanë aleat vetëm qeverinë dhe këtë maxhorancë për zgjidhjen e problemeve të tyre. Të gjithë ata që i shtyjnë studentët të mos dialogojnë me qeverinë gabojnë, sepse është diçka aspak normale dhe jo e natyrshme për një kategori që së shpejti do të marrë në dorë të ardhmen e vendit, pasi koncepti i protestës është të dëgjohesh për ato probleme që ti ke dhe të dialogësh në funksion të zgjidhjes të problemeve. Po e theksoj edhe një herë që në aspektin kushtetues dhe financiar buxheti i vitit 2019 i ka të gjitha mundësitë të furnizojë kërkesat e studentëve, duke filluar me subvencionimin e konsiderueshëm të tarifave, si dhe duke marrë parasysh të gjitha pikat që kanë parashtruar studentët.

Sa i takon dekretit, ai ka kthyer mbrapsht për rishikim buxhetin e 2019-ës, pa referuar asnjë detaj qoftë në aspektin e financimit të arsimit në tërësi, të arsimit të lartë në veçanti, qoftë duke iu referuar ndonjë kërkesë specifike të studentëve. Pra, praktikisht e ka kthyer buxhetin në parim. E thënë kjo, duke qenë se qeveria është e gatshme të dialogojë menjëherë dhe pret me padurim për të dialogur me studentët në funksion të një pakti kombëtar për arsimin së bashku me studentët, po jua theksoj sërish se qeveria dhe kjo maxhorancë janë sot aleatët e vetëm të studentëve. Kjo është arsyeja që ju si përfaqësues të maxhorancës, ne si përfaqësues të qeverisë, Kryeministri, përditë lutemi për dialog në mënyrë që të arrijmë atë, e cila besoj do të jetë në themel të përmirësimit të arsimit në tërësi dhe të arsimit të lartë në veçanti, të paktit kombëtar për arsimin.

Duke ju thënë këto, e mendoj krejt të natyrshme dhe si një akt normal rrëzimin e dekretit që na ka dërguar Presidenti këtu. Unë lutem që edhe Presidenti të fillojë të lutet për dialog të studentëve me qeverinë. Lutja për dialog, do të ishte një kontribut i rëndësishëm në funksion të zgjidhjes së problemeve që realisht kanë studentët. Çdo refuzim ose ndihmë për refuzim ndaj dialogut është si t'i bësh tradhti kauzës shumë të drejtë dhe legjitime të studentëve.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit!

A ka pyetje lidhur me dekretin e Presidentit apo për opinionin e qeverisë për dekretin e Presidentit

Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër!

Pyetja ime është shumë e thjeshtë. Nevojat e studentëve, plotësimi i këtyre 8 pikave dhe përtej realizohet brenda këtij buxheti që ne kemi aprovuar dhe asaj kuote që ne kemi për arsimin e lartë dhe për arsimin në tërësi? Kjo ishte pak a shumë ajo që ju na thatë, në qoftë se e kam kuptuar mirë.

Erion Braçe – Urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Po, patjetër është brenda buxhetit, sepse buxheti ka instrumentet, dinamikën, shumat për të plotësuar në themel pikat e kërkesave të studentëve. Pra, jo vetëm subvencionimi i tarifave, por jam duke folur që në bazë të këtij dokumenti të ndërtojmë një pakt

kombëtar për arsimin, i cili të hedhë piketat e rëndësishme për vitet që vijnë, pra edhe këta që janë studentë sot të kenë kontribuar për studentët e nesërm. Përgjigjja është e drejtpërdrejtë.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Zotit Ministër, siç jeni vënë në dijeni nga dekreti i Presidentit, argumentet e tij lidhen drejtpërdrejtë me atë që edhe kolegët e kanë shqetësim, prandaj do t'ju lutesha ta mirëkuptonit pyetjen që do t'ju bëj, si dhe do të insistoj pas asaj që ju pyeti zoti Pëllumbi.

Janë dy çështje në ato 8 pika, për të cilat është vënë në lëvizje edhe Presidenti i Republikës, natyrisht me mënyrën e tij. Do të ishte krejt normale që Presidenti i Republikës t'ju kishte thirrur ju apo cilindo tjetër, qoftë edhe nga ky komision, për të marrë informacionin e plotë për buxhetin e shtetit për vitin 2019, natyrisht edhe për instrumentet që ai ka për të përmbushur edhe kërkesa të këtij karakteri, por dy janë shumë të qarta.

E para, është çështja e tarifave të studentëve, e regjistrimit të studentëve.

E dyta, çështja e përmirësimit të kushteve në konviktet universitare.

Dua t'ju pyes konkretisht. Cilat burime do të përdoren për të dyja këto çështje. E para për të subvencionuar siç thoni ju tarifat?

E dyta, cilat burime do të përdoren për të përmirësuar kushtet në konviktet universitare?

Arben Ahmetaj – Zoti kryetar, burimet për subvencionimin e tarifave të studentëve janë në varësi të rezultateve të dialogut, sepse qeveria ka një ofertë dhe një propozim shumë serioz për subvencionimin e tarifave, që shkon, siç e ka thënë edhe Kryeministri, deri në përjashtim nga pagesa e tarifës për kategori të rëndësishme. Pra, po jua theksoj që ta dinë edhe qytetarët, se në propozimin që ka qeveria, i cili shkon përtej 8 pikave presupozohet që studentët e ekselencës, të cilët për këtë arsye janë ridefinuar studentët jo thjesht me 10.00, por edhe ata nga 9 në 10, të trajtohen me bursë 10 mijë lekë në muaj dhe me përjashtim nga pagesa e tarifës, pra, subvencion 100 % nga buxheti i shtetit.

E njëjta gjë ndodh me një kategori në nevojë, që u referohemi si studentë që vijnë nga familje që përfitojnë ndihmë ekonomike. Janë 6300 studentë që vijnë nga këto familje, të cilët do të përfitojnë të njëjtin trajtim si studentët e ekselencës, do të përjashtohen nga pagesa e tarifës, buxheti i shtetit do t'i subvencionojë 100% tarifën e Bachelorit, si dhe do t'u afrojë edhe bursë 10 mijë lekë në muaj. Këto janë brenda grantit që i akordohet universitetit, por theksoj se është shumë e rëndësishme të dialogojmë me studentët për t'i detajuar dhe për t'i treguar edhe burimet.

Pyetja juaj është e drejtpërdrejtë dhe unë ju falënderoj, 7,4 miliardë është pjesa e grantit që ne akordojmë për universitetet, kështu që kemi mundësinë të plotësojmë të gjithë atë subvencionim që do të realizojmë në dialog. Ne kemi bërë publik propozimin e qeverisë në referencë dhe në reflektim të kërkesave të studentëve. Në të njëjtën kohë, për dijeninë tuaj, brenda propozimit ka edhe një reduktim, siç e theksoi edhe Kryeministri, të tarifave të konvikteve ende të paristrukturuara. Mendohet që tarifa të shkojë në një zbritje gjysmë për gjysmë, që është një subvencionim sërish i drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit.

Së treti, janë investimet, që për herë të parë, për hir të së vërtetës, po kryhen nga qeveria shqiptare nëpërmjet një financimi të KfW-së, të qeverisë gjermane. Ka qenë kërkesa e Kancelares gjermane dhe që tani me transhe ka shkuar mbi 18 milionë euro. Nuk janë projektet 3 D, jemi duke folur për projekte që janë realizuar dhe po realizohen. Në të njëjtën kohë qeveria do t'i akordojë brenda 3 ditësh Bashkisë së Tiranës fondin për rikonstruksionin e 6 godinave. Në të njëjtën kohë Kryeministri është duke diskutuar drejtpërsëdrejti me KfW-në, Bankën e Zhvillimit, të qeverisë gjermane, për të akorduar, në muajt e parë të vitit që vjen, edhe një kredi, e cila do të shkojë drejtpërsëdrejti në rikonstruksion të godinave të Qytetit Studenti dhe nuk jam duke folur më për Tiranën, por edhe për ambientet jashtë Tirane, në Gjirokastrë, në Elbasan, në Durrës ose në Shkodër dhe Korçë. Pra, ka një qasje tërësore për të përmirësuar atë që iu referuat, prandaj theksova që ne presim me padurim për të bërë atë dialog të rëndësishëm, për të arritur në një pakt afatgjatë për arsimin brenda të cilit do të detajojmë së bashku me studentët edhe këto që unë thashë. Sigurisht që dialogu do t'i qartësojë dhe zyrtarizojë dhe aty pastaj qeveria do të jetë në gjendje së bashku me studentët të dalin krah për krah dhe të shpallin paktin kombëtar për arsimin. Pra, duke iu përgjigjur me një fjali pyetjes suaj, burimet janë brenda 42 miliardëshit për arsimin, brenda 7,4 miliardëshit të grantit për arsimin, brenda 300 milionëshit të subvencionimit të konvikteve, plus 300 milionë që të akordohet për rikonstruksion, gjithashtu, edhe 18 milionë euro, të cilat në vazhdimësi bëhen të disbursueshme dhe në funksion të projekteve të konvikteve dhe godinave të studentëve.

Erion Braçe- Pra, ju jeni i bindur se ka para brenda buxhetit të shtetit për të adresuar të paktën këto dy pika për të cilat folëm në fillim dhe pastaj edhe për të tjera, për të cilat qeveria është e angazhuar?

Arben Ahmetaj – Po, ne kemi mundësi që në janar të avancojmë me paketën që qeveria ka strukturuar.

Evis Kushi- Siç e dimë të gjithë, ligji i ri për arsimin e lartë u ka dhënë më shumë autonomi universiteteve në ushtrimin e funksioneve të tyre, përfshirë këtu edhe menaxhimin e burimeve financiare. Gjatë këtyre ditëve ka pasur shumë lajme nëpër medie, jo të gjitha mund të jenë të vërteta, por ka pasur akuza për universitetet që abuzojnë me fondet, domethënë nuk shkojnë paratë direkt për rritjen e arsimit cilësor ose në shërbim të studentëve, por mund të shkojnë për makina ose shpenzime të tjera, thashë edhe një herë me rezervë e kam këtë lajm, përderisa gjatë këtyre ditëve të fundit ka pasur shumë akuza. Unë dua të di çfarë mekanizmesh kontrolli ka në lidhje me këtë. E di shumë mirë që ato kanë autonomi dhe janë objekt i Kontrollit të Lartë të Shtetit, por desha të di nga qeveria, nga ministria, mbase nuk jeni ju ministria direkt përgjegjëse, por a mund të rriten mekanizmat e kontrollit brenda këtij kuadri ligjor që kemi, në mënyrë që paratë të shkojnë më shumë te studenti dhe jo në luks ose pretendime të tjera?

Arben Ahmetaj – Megjithëse instrumenti që ligji detyron buxhetin është transfera në formë granti për universitetet, universitetit i lihet në dorë bordit të administrimit dhe institucioneve që kanë ndërtuar. Por sigurisht që ka një instrument kontrolli që është transparenca, ajo që ne bëjmë për buxhetin e shtetit, çdo qytetar mund të futet në websitin e Ministrisë së Financave dhe të shohë në kohë reale çfarë shpenzimesh kemi planifikuar ne, madje dhe çfarë shpenzimesh janë bërë në kohë të ndryshme. Një nga kërkesat e studentëve është transparenca që do ta detyrojë administrimin e universitetit të jetë shumë i përgjegjshëm për të çuar fondet. Ka disa mënyra debati, ka disa mënyra kontrolli, për shembull, nëpërmjet rrjeteve sociale që studentët të kenë mundësi të gjykojnë diskutojnë dhe të kërkojnë një mënyrë administrimi të përgjegjshme transparente dhe një alokim të shëndetshëm fondesh në drejtim të përmirësimit të kushteve të jetesës ose mësimarrjes e mësimdhënies. Besoj se një nga pikat është transparenca. Ne presim të gjithë me padurim të dialogojmë me studentët në mënyrë që të arrijmë atë që duam, paktin kombëtar për universitetin.

Erion Braçe- A ka pyetje të tjera?

Ervin Bushati – Duke u mbështetur edhe te pyetja e zonjës Kushi, që e shoh shumë të drejtë, por, në fakt, duke i lënë një kohë kaq të shkurtër në autonomi të plotë universitetet, mos ndoshta kërkon edhe masa të ndërmjetme një farë kontrolli të buxhetit dhe fondeve që kanë këto universitete? Deri në momentin që të jenë të përgjegjshëm ndaj votës si zgjidhen dhe transparencës, që transmetojnë te studentët, e shikojmë që kemi një moment ngërçi. Pra, mbase duhen instrumente që të kontrollohen dhe të vihen edhe kufij që kaq duhet të shkojë për

studimet, kaq duhet të shkojë për kërkimin shkencor dhe më pak pastaj në përqindje për makina të reja ose arredime e të tjera. Pra, mos duhet një fazë e ndërmjetme në transparencën e mënyrës se si investohet? Të mos të lihet te granti dhe kaq mbaron.

Arben Ahmetaj – Besoj se në kushtet dhe situatën e krijuar gjëja e parë që duhet të bëjmë është të analizojmë se çfarë ka ndodhur.

Pra, siç iu referua edhe zonja Kushi, që nuk e dimë sa të vërteta janë fjalët për keqmenaxhim të fondeve, së pari, së bashku me studentët dhe pedagogët t'u bëjmë një analizë fondeve se ku kanë shkuar në vite, pra në këto 4 vjet që autonomia është garantuar me ligj.

Së dyti, patjetër që ne kemi mundësi edhe ju si ligjbërës, edhe ne si qeveri së bashku me studentët dhe universitetin të vendosim instrumente të ndërmjetme, të cilat garantojnë transparencë mbi të gjitha dhe kontroll, si konsekuencë për fondet që shpenzohen në universitete. Autoriteti që të financon ka të drejtë të të kontrollojë, që do të thotë që në rastin konkret parlamenti nëpërmjet qeverisë që të financon ka të drejtë të të ushtrojë kontroll pa të cenuar autonominë, vetëm duke verifikuar që granti që ka dhënë si parlament ka shkuar aty ku ti ke caktuar objektivat, ka shkuar në funksion të auditorëve, të studentëve, miradministrimit të ambienteve, të përmirësimit të jetës së studentëve në konvikte, në shkollë, të mësimdhënies, në laboratorë, në shkencë. Ky është parim financiar, ai që të financon, ka të drejtë të të kontrollojë.

Ervin Bushati – Një nga kërkesat kryesore ka qenë përmirësimi i standardeve në konvikte dhe është e drejtë. A ka një kosto buxheti i shtetit sa na kushton ne për një student ndenja në konvikt për një muaj?

Arben Ahmetaj -Ka një kosto që paguajnë studentët, ka edhe një kosto reale, e cila subvencionohet nga buxheti i shtetit. Kostoja për student është rreth 6 mijë lekë në muaj dhe këtë e paguajnë vetë, ndërsa qeveria, Ministria e Arsimit nëpërmjet subvencionit prej 300 milionë lekësh subvencionon për të mbajtur operacionin e ndërmarrjes së studentëve në këmbë. Më duhet të them që ndërmarrja nuk është fitimprurëse, pra qytetarët duhet ta dinë, është e drejtë që kushtet aty janë larg të qenit normale për një pjesë të godinave, por në të njëjtën kohë duhet parë me kujdes çfarë ndodh me këtë ndërmarrje, si administrohet dhe sa është kostoja reale e akomodimit për një student në muaj, sepse zyrtarja është 6 mijë lekë, sigurisht që kostoja është shumë më e lartë se 6 mijë lekë, por këtu duhen parë të gjitha hapat e administrimit, që nga si administrohet ndërmarrja, sa njerëz ka në ndërmarrje a e paguan ujin dhe energjinë. Duhet ta dini se ndërmarrjet e studentëve sot janë debitorë ndaj ujit dhe energjisë. Pra, kur diskutojmë për

kosto jetese, ajo është kosto jetese e subvencionuar, kushtet janë shumë larg të qenit normale për një pjesë të mirë të studentëve, por besoj se kjo është logjika investimit për një kampus të ri universitar dhe në rikonstrukcion të plotë të godinave të Qytetit Studenti, por jo vetëm.

Blerina Gjylameti – Edhe pse mund të themi që në vite ka pasur shumë ndryshime, ka pasur rezultate në marrëveshjet që ju keni lidhur me universitetet për intershipe për studentët, megjithatë, duke vlerësuar kërkesat e studentëve, si kërkesa që qëndrojnë, duhet realisht të përmirësohet puna në përmbushje të këtyre kërkesave. Nga ana tjetër, duke vlerësuar edhe fjalën që dha Kryeministri për një marrëveshje me të gjitha universitetet për punësimin e të gjithë të rinjve që vijnë me nota të larta, unë kam një pyetje dhe një kërkesë.

Së pari, për pjesën e fondit të ekselencës, unë e di që është pjesë e Ministrisë së Arsimit, por edhe nga ana juaj ka mbështetje buxhetore për këtë zë dhe mendoj se për këtë duhet të bëjmë më shumë. Pra, të mbështesim ata që janë ekselencia e vendit, qoftë për vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë, flasim për pjesën master dhe këtu, meqenëse tarifat nuk vendosen nga qeveria, por, për shkak të ligjit të arsimit të lartë, nga bordet, do të duhet të rishikohen, sepse është një nga kërkesat që nuk është ngritur zëri duke e ndarë nga kërkesat e tjera, por që ka shumë peshë. Nga ana tjetër, të mbështesim pikërisht me fonde nëpërmjet fondit të ekselencës. Unë mendoj se investojmë sot për çfarë do të jetë nesër e ardhmja. Këtu është kërkesa ime për të parë nëpërmjet rialokimeve gjatë vitit pjesën e zërit për fondin e ekselencës, pra mbështetjen buxhetore për fondin e ekselencës, sepse është shumë e rëndësishme infrastruktura në auditorë, universitare, në konvikte, por është e rëndësishme që ne të investojmë te fondi i ekselencës.

Arben Ahmetaj– Jam dakord me çdo mendim tuajin, do të ulemi të dialogojmë me studentët. Kemi një pakt kombëtar për arsimin brenda të cilit t'i reflektojmë edhe këto ide që ju ndani. Unë dua të ndaj edhe idenë e kryeministrit për të alokuar në administratë një numër të konsiderueshëm pozicionesh në Ministri të Financave, Arsimit, e të tjera pra në të gjithë administratën publike të alokohet një numër i konsiderueshëm vende pune, gati 1000 për studentët e ekselencës, që të kenë mundësi të futen në administratë. Unë besoj se është një formë e avancuar e intershipit, e paguar dhe për të promovuar studentët e ekselencës. Por është e domosdoshme të ulemi të dialogojmë me studentët, të arrijmë një pakt, i cili t'i qëndrojë kohës.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera? Nuk ka pyetje të tjera.

Zoti Ministër, nga ajo që ju thatë këtu, dhe që Kryeministri ka diskutuar çdo ditë me faktorë të ndryshëm interesi lidhur me këtë çështje, tek arsimi i lartë do të shkojnë më shumë

para në të gjitha format që deklaruar këtu e për të cilat natyrisht që po kërkohet me insistim dialog edhe me studentët. Unë nuk mendoj se në arsimin e lartë ka pasur pak para, edhe në harkun e këtyre 4 vjetëve, po ka pasur më pak para në vitin 2006, 2007 gati 3 herë më pak se sot ose në vitin 2019. Pra, atje ka një peshë të konsiderueshme buxheti i shtetit, dhe natyrisht bashkëfinancojnë edhe studentët nga tarifat. Me zgjidhjen e propozuar nga Kryeministri, nga ju, si ministri, kuptoj që pjesa e buxhetit të shtetit për arsimin e lartë do të rritet. Shqetësimi që ne kemi është efektiviteti i përdorimit të këtyre parave. Kurrkush, rektor, dekan, borde administrimi, përfaqësues të universitetit në to, ose përfaqësues të qeverisë në to nuk mund të fshihet më pas historisë nuk ka para. 120 milionë dollarë në vit janë 200 milionë dollarë më shumë se buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, që akomodon gjysmën e popullsisë së vendit në punë. Problemi që kemi lidhet me efektivitetin e parave, çfarë do të financojmë: meritën akademike ose parazitizmin partiak të partive apo të forumeve politike brenda universitetit? Çfarë do të financojmë, 3 palë investime për ngrohje vetëm një godinë? Ngrahje qendrore, chiller dhe pastaj edhe kondicioner si në një fakultet këtu në zemër të Tiranës, apo do të financojmë struktura të qëndrueshme universitare, që ofrojnë kushte normale për studentët dhe për t'u kthyer në produkt për familjet e tyre, por edhe për shoqërinë shqiptare?

Unë mbështes kolegët e mi në momentet që përfundon dhe procesi i zgjedhjes së kryetarit të KLSH-së, ky komision do të ketë të gjithë vullnetin për të kërkuar edhe nga ai institucion një kontroll të plotë financiar. Paguajmë para për pedagogë, për orë mësimi që nuk bëhen dhe për studentë që nuk kanë asnjë lloj mundësie të komunikojnë me pedagogët e tyre. Është verifikuar ndonjëherë ky fakt? Kurrë deri më sot.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka prodhuar 2-3 raporte të rëndësishme dhe profesionale për Universitetin e Tiranës, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga prokuroria e Republikës. Një histori tjetër kjo akoma edhe më e rëndë.

Kështu që, forcimi i kontrollit me fokus produktin e këtyre parave, qoftë nga pikëpamja akademike, qoftë nga pikëpamja e strukturave të qëndrueshme arsimore në të gjitha universitetet e vendit, duhet të jetë një element themelor që duhet të shoqërojë pa asnjë diskutim rritjen e fondit për arsimin, siç edhe këtu u referua.

Tani kalojmë në votim. Ka vetëm një votim për dekretin, ai pranohet ose rrëzohet. Kush është pro dekretit të Presidentit? Nuk ka. Kundër? Abstenim? Nuk ka. Dekreti i Presidentit rrëzohet.

Duke e mbyllur këtë çështje, po e shfrytëzoj këtë rast për të përsëritur edhe një apel: zgjidhja tashmë është shumë e qartë. Ajo është e mbuluar financiarisht 100%, qoftë për kërkesën që lidhet drejtpërdrejt me tarifat, qoftë për kërkesën që lidhet me përmirësimin e kushteve në universitete dhe në godinat e banimit të studentëve. Ajo që po kërkojmë është një zgjidhje shteruese në funksion të atyre që thashë: vlerësimit të meritës akademike, nxitjes drejt kësaj merite dhe natyrisht të rrëzimit të mureve për ato kategori sociale që janë vërtet në nevojë, duke i mbuluar ne, buxheti i shtetit, taksapaguesit e Republikës së Shqipërisë, edhe ata që sot u zihen rrugët në aktivitetin e tyre lart e poshtë, në aktivitetin e tyre të përditshëm, për shkak të nevojave jo të studentëve, por të partive politike që duan t'i përdorin këto kërkesa legjitime. Natyrisht, në rast se do të ketë një dialog, është shumë e qartë që zgjidhja do të jetë shteruese dhe përfundimtare, në rast se nuk do të ketë dialog, çdo zgjidhje e njëanshme do të ketë litarin jashtë. Pra, përsëri do të vazhdojnë të kërkojmë. Kështu që, dialogu është rruga më e mirë për të adresuar, pse jo brenda këtij viti, të paktën ato dy problematika që lidhen me anën financiare. Të gjitha të tjerat janë të mundshme për t'u realizuar në kohë reale, por kësaj radhe duke ndarë përgjegjësitë: qeveria të sajat, studentët të tyre, për një universitet që duhet të jetë ndryshe nga ky që është sot, publik dhe që financon në mënyrë të qartë meritën akademike.

Faleminderit!

Zoti Ministër, faleminderit!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 18. 12. 2018, ora 09 : 30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 10929, datë 05.11.2018 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Arben Pëllumbi, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Evis Kushi, Ilir Xhakolli, Roland Xhelilaj dhe Xhevit Bushaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Reme Lala, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – Ministër i Financave dhe Ekonomisë

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhembë – Drejtore e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Arbër Lleshi – Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ridvan Bode, Suela Popa, Edlira Luçi, Artan Hoxha, Arben Malaj, Luljeta Minxhozi

Erion Braçe –Vazhdojmë me çështjen e dytë, dekretin e Presidentit “Për propozimin e kandidatit për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Siç ju e dini, ky komision është angazhuar edhe më herët në shqyrtimin e dekretit të Presidentit “Për propozimin e kandidatit për Kryetar të Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin për Kontrollin e Lartë të Shtetit është zhvilluar një seancë dëgjimore me kandidatin e propozuar nga Presidenti i Republikës, zonjën Vitore Tusha. Është marrë informacioni i nevojshëm në funksion të ligjit për Kontrollin e Lartë të Shtetit, por edhe informacioni mbi vizionin e kandidates për të drejtuar Kontrollin e Lartë të Shtetit. Jemi në fazën që ky komision duhet të administrojë një raport të tijin dhe natyrisht, t’i propozojë seancës plenare opinionin e tij për vendimmarrje e cila është ekskluzive e seancës plenare.

Komisioni, në funksion të shqyrtimit të kandidaturës së paraqitur nga Presidenti i Republikës, administroi raportin e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë mbi procesin e ngritjes së Këshillit të përkohshëm të Emërimeve në sistemin e Drejtësisë”, të përcjellë Kuvendit me vendim nr. 4, datë 16. 11. 2018, si dhe praktikën e depozituar nga Presidenti i Republikës bashkëlidhur dekretit nr. 10929, datë 05. 11. 2018 “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Praktika të tjera të mëparshme, për të cilat, gjatë procedurave të shqyrtimit parlamentar, është bërë analiza e plotësimit ose jo të kriterëve formale të kandidaturave për postin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit në kohë të ndryshme këtu në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, së pari shqyrtoi raportin e Komisionit të pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115\2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” mbi procesin e ngritjes së Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë”, si dhe procedurën e shortit të organizuar pranë Kuvendit për ngritjet e KPESD-së për vitin 2019. Duke iu referuar raportit të Komisionit të Pavarur dhe procedurave të shortit, që çuan në ngritjen e KPESD-së për vitin 2019, konstatohet se zonja Vitore Tusha, për shkak të detyrës aktuale si anëtare e Gjykatës Kushtetuese, mban edhe funksionin e Zëvendëskryetarit të KPESD-së.

Komisioni i Ekonomisë vlerëson se KPESD-ja, midis të tjerave, ka një rol vendimtar dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm në procesin e ngritjes së organeve të reja të drejtësisë dhe, midis të tjerave, pritet që me urgjencë të ushtrojë të gjitha kompetencat përfshirë ato lidhur me

verifikimin e përmbushjes së kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale e morale të kandidatëve për:

1. Anëtar të Gjykatës Kushtetuese (dje ajo mbeti me një anëtar)
2. Inspektor të Lartë të Drejtësisë.

Emërimi i Zonjës Tusha në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit do të rrezikonte vijimin normal të organit të ri të sapokrijuar, duke vënë në dyshim procese më të rëndësishme sesa ai i zëvendësimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Kjo pasi duhet mbajtur në konsideratë gjendjen aktuale e KPESD-së me dy anëtarë më pak, kushtin ligjor, sipas të cilit, përfaqësuesi më i vjetër i zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese, është automatikisht zëvendëskryetar i KPESD (kjo detyrë i ngarkohet automatikisht nga ligji zonjës Vitore Tusha), zëvendësimi i saj pasi kanë kaluar afatet ligjore, është ezauruar procedura e hedhjes së shortit dhe është ngritur KPESD-ja për vitin 2019, (shorti hidhet një herë në vit) bëhet i pamundur pasi Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar që KPESD-ja, e më pas Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ngrihet një herë në vit dhe funksionon gjatë një viti, duke u zëvendësuar me një proces stafetë nga njeri vit tek tjetri.

Në lidhje me shqyrtimin e kriterëve formale të parashikuara nga neni 20 i ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave konstaton se kandidatura plotëson kriteret për sa i takon:

- a) arsimit;
- b) kualifikimeve në fushën e dhënies së drejtësisë dhe përvojë pune në këtë fushë prej më shumë se 10 vjet;
- c) plotëson dhe mund të vlerësohet maksimalisht për integritetin moral dhe profesional në fushën e dhënies së drejtësisë, vlerësim ky i konfirmuar edhe nga procesi i vetingut, të cilin zonja Tusha e ka kaluar prej kohësh;
- d) nuk ka asnjë rast, në të cilin të ketë qenë subjekt i shqyrtimit nga drejtësia dhe aq më pak të jetë dënuar për kryerjen e një veprë penale.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, duke vlerësuar për sa më sipër kandidaturën, konstaton se në gjithë karrierën e zonjës Tusha nuk evidentohet përvojë profesionale në çështje të auditimit sipas kuptimit të termit në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në të gjithë zërat e tij, përfshirë auditimin financiar, auditimin e

performancës, auditimin e IT-së, e të tjera terma apo procese të parashikuara nga ligji “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Edhe angazhimet e tjera profesionale të zonjës Tusha janë të fokusuar në lëndë si “E drejtë europiane” apo “Të drejta të njeriut”, të cilat në çdo rast vlerësohen nga komisioni si shumë të rëndësishme dhe ndihmojnë në procesin e dhënies së drejtësisë në çdo raport që lind midis shtetasve dhe subjekteve nga njëra anë dhe sistemit gjyqësor nga ana tjetër. Por Komisioni i Ekonomisë dhe Financave, pas arsyetimit si më sipër, evidenton faktin që një eksperiencë e posaçme në legjislacionin financiar dhe auditimin financiar, është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme nga eksperiencia të tjera, për arsye të specifikës dhe unicitetit të funksioneve që kryen Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Të gjitha eksperiencat e mëparshme të zonjës Vitore Tusha, përfshirë eksperiencat akademike, janë larg specifikës së çështjeve financiare në përgjithësi dhe auditimit në veçanti, si veprimtaritë më të rëndësishme të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të tilla si auditimi financiar, auditimi i performancës, auditimi i përputhshmërisë, auditimi i rregullshmërisë dhe ai i IT-së”.

Edhe nga analiza e shqyrtimit të dokumentacionit parlamentar, në rastet e mëparshme konstatohet i njëjti vlerësim dhe interpretim i dispozitave të nenit 20, të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Kështu, gjatë shqyrtimit të Dekretit nr. 7137 datë 27. 10. 2011, “Për propozimin e zotit në fjalë në detyrën e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Komisioni i Ekonomisë dhe Financave i ka rekomanduar seancës plenare rrëzimin e dekretit, me arsyetimin se kandidatura nuk kishte eksperiencë direkte në fushën e kontrollit financiar dhe ekonomik. Edhe atëherë rasti ishte i ngjashëm dhe profili jurist i kandidaturës u konsiderua si i pamjaftueshëm për të arsyetuar lidhur me kualitetin e kandidaturës në fushën e kontrollit ekonomik dhe financiar, si specifikë e domosdoshme për mirëfunksionimin e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe përmbushjen e objektivave të vendosura nga ligji për këtë institucion.

Në këto kushte, në përfundim të shqyrtimit, komisioni, mbështetur në pikën 7 të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i propozon Kuvendit mosmiratimin e kandidaturës së paraqitur me dekretin nr.10929, datë 05.11.2018, të Presidentit të Republikës, “Për propozimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Ky është raporti i hartuar nga komisioni. Do të duhet që ky raport t'i nënshtrohet votimit këtu dhe pastaj edhe në seancë plenare për atributin e saj për të votuar për dekretin e Presidentit.

Ka ndonjë objeksion, pyetje apo vërejtje për raportin e këtij komisioni? Secili nga ju ka të administruar në dosjen respektive edhe raportin e Komisionit të Monitorimit të Reformës në Drejtësi, raport i administruar edhe nga komisioni, adresuar këtij komisioni dhe komisionit të Çështjeve Ligjore. Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është kundër këtij propozimi të komisionit? Nuk ka. Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet raporti i komisionit me propozimin për të rrëzuar dekretin e Presidentit të Republikës “Për propozimin e Kandidatit për Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Faleminderit!

Mbledhja për këto pika mbyllet këtu. Do të vazhdojmë në orën 11:00 në sallën poshtë me dëgjesat për kandidatët e propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe grupe deputetësh për vendet vakante në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretari i komisionit
Elvi Prifti